

Përmbajtja

- 2 Përfshirja e Perspektivës Gjimore në Proceset Paqësore
- 2 Fushata "Të Njohim të Drejtat"
- 2 Shënime nga takimi i RRGK-së në muajin korrik
- 3 Transferimi i Kompetencave të Institucionit të Ombudspersonit
- 3 RRGK Përkrahë Draft Strategjinë për të Drejtat e Njeriut
- 3 Reforma paraqet Trendet Elektorale, kërkesë për mbështetje të vazhdueshme
- 3 QKSGJ ka publikuar edhe dy botime
- 4 Informata nga Anëtarët e RRGK

Njohtimet

Ditët e Trashëgimisë Kulturore Evropiane në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.....**15-20 shtator**

Mbledhja e ardhshme e RRGK.....**7 nëntor, ora, 11:00**

Koncerti në Prishtinë. "Të Njohim të Drejtat"**25 nëntor**



RRGK Kërkon Përkrahje për Strehimoret e Viktimave të Dhunës në Baza Gjimore

Më 15 korrik, anëtarët e RRGK-së zhvilluan një takim me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Z. Selmanaj, për të njoftuar atë lidhur me mungesën e legjislacionit të përshtatshëm i cili do të adresonte dhunën në baza gjimore. Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, institucionet duhet ende të punojnë për ta rregulluar çështjen e dhunës mbi baza gjimore.

Anëtarët e RRGK-së janë dëshmitare të problemeve që hasin në punën e tyre në strehimore, nëpër tërë Kosovën. Aktualisht, strehimoret janë e vetmja derë e hapur për njerëzit të cilët janë viktimë të dhunës në baza gjimore. Strehimoret në Kosovë kanë shumë probleme, por një



Anëtarët e RRGK-së takohen me Ministrin Selmanaj për të kërkuar përkrahje për shtëpitë e sigurta dhe për adresuar çështjen e dhunës në baza gjimore.

problem kyç është mungesa e mbështetjes institucionale.

Në këtë takim, anëtarët e RRGK-së ia prezantuan këtë problem Ministrin Selmanaj. Delegacioni i RRGK-së ishte në përberje të Sevdije

Ahmetit nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (Prishtina), Sakibe Doli - Dobruna nga Shtëpia e Sigurt (Gjakovë), Lumnije Deçani nga Qendra për Mirëqenien e Gruas (Pejë), Elita Reshtani nga Qendra për Gra dhe Fëmijë (Prizren), vazhdimi fq. 4

"Ne dëshirojmë të mbështesim gratë të cilat janë viktimë të dhunës në baza gjimore"
- Minister Selmanaj

RRGK takohet me PSSP lidhur me Rezolutën 1325

RRGK dhe Zene Zenama (Gratë për Gratë) Sarajevë, me ndihmën e UNIFEM-it janë duke përpiluar një raport lidhur me shkallën e implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në Kosovë dhe Bosnjë. Në raundin e parë janë zhvilluar intervista me institucionet lokale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe zyrën e Kryeministrit, UNMIK, OSBE dhe Shërbimin Policor të Kosovës.

Raundi i dytë i intervistave ka përfunduar në korrik, 2005. Gjatë këtij raundi të intervistave RRGK-ja zhvilloi një intervistë me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Soren Jessen-Peterson.

Përfaqësuesja e RRGK-së me këtë rast ka pyetur, "Deri në çfarë shkalle është implemen-



Sören Jessen-Petersen,
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

tuar rezoluta brenda UNMIK-ut.

"Përveç disa ndryshimeve të cilat i kam bërë unë, siç është kërkesa që Zyra për Çështje Gjimore të vendoset në zyrën time në mënyrë që të jetë më në qendër, nuk kemi qenë edhe aq të mirë në këtë drejtim," tha ai. "Kam dashur të shfrytëzojë rastin për të bërë ndryshime në udhëheqësin e shtyllave të UNMIK-ut, por ishin zëvendësuar me burra. Përkundër kërkesës time në Nju Jork dhe administratës këtu për të identifikuar kandidatë gra të kualifikuara, kemi dështuar. Pra, udhëheqësija jonë ende është e dominuar nga burrat, që nuk është sinjal i mirë."

Shënime nga Takimi i Rrjetit

Në takimin e fundit, RRGK njoftoi anëtarët e saj se deri më tani zyrtarisht janë regjistruar 77 organizata si anëtare të Rrjetit. U prezantuan shkurtimisht aktivitetet e RRGK-së për dy muajt e fundit. Një aktivitet i rëndësishëm i RRGK-së ishte takimi me Kryeministrin për implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në këtë takim, përfaqësueset e RRGK-së kanë theksuar që shoqëria civile është duke monitoruar qeverinë në implementimin e Planit Veprues Nacional për Arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovë.

Më 27 dhe 28 maj, në Selanik të Greqisë, Banka Botërore ka organizuar konferencën rajonale me temën "Tregu i Punës, Strategji për Zhdukjen e Varfërisë." Ministri i Ekonomisë dhe Financave ka prezantuar raportin për Kosovën, ndërsa Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së, Igballe Rogova ka prezantuar raportin nga shoqëria civile.

Takimi dy mujor i RRGK-së, vazhdoi me prezantimin dhe shkëmbimin e informatave për projektet dhe aktivitetet e anëtarëve dhe partnerëve të RRGK-së (lokal dhe ndërkombëtar).

o Medika Kosova dha një përshkrim të projekteve të tyre, që iu ofron grave shërbime psikosociale, gjinekologjike dhe mbështetje ligjore.
o Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit ka prezantuar Planin për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe themelimin e Agjencisë për Barazi Gjinore në zyrën e kryeministrit.
o Projekti për shoqërinë civile i organizatës IREX, i cili ka filluar më 1 qershor, së shpejti do të fillojë me programet për ndihmë shoqërisë civile në Kosovë.

o OKSGJ ka publikuar edhe dy botime (Shikoni artikullin, faqe 3).

Përfshirja e Perspektivës Gjinore në Proceset Paqësore në Kosovë

Stockholm, Suedi, 8 korrik 2005

I nderuar PSSP Z. Sören Jessen-Petersen,

Fondacioni Kvinna till Kvinna është e brengosur që përvoja dhe ekspertiza e grave dhe organizatave të grave në Kosovë do të nënvlerësohet në përgatitjet e ardhshme për bisedimet për statusin e Kosovës. Ne dëshirojmë të iu përkujtojmë se Rezoluta 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, e Këshillit të Sigurimit, në mënyrë të veçantë kërkon që gratë dhe organizatat e grave të jenë të ftuara dhe të marrin pjesë në të gjitha nivelet e proceseve paqësore, në ato formale dhe jo formale. Tani është koha për gratë nga Kosova të marrin pjesë, në vendim marrje, në të dyja pozitat e krijuara brenda Forumit atë politike dhe të ekspertizës, Sekretariatit, Grupi i Ekspertëve dhe Grupet Punuese për të statusin e ardhshëm të Kosovës.

Fondacioni Kvinna till Kvinna Foundation ka mbështetur dhe punuar me organizatat e grave në Kosovë që nga viti 1994. Këto organizata janë shumë mirë të organizuara në komunitetin e tyre dhe shumë pre tyre janë të përfshira në proceset politike dhe vendim marrje në nivele të ndryshme, në shoqërinë Kosovare. Ato janë duke ndërtuar paqen përgjatë linjave të konfliktit dhe duke gjetur gjuhë të përbashkët. Në mënyrë që të arrihet një zgjedhje e qëndrueshme dhe demokratike për të ardhmen e Kosovës, në këtë proces të vazhdueshëm duhet edhe njohurit e grave.

Fondacioni Kvinna till Kvinna kërkon nga UNMIK-u dhe në mënyrë të veçantë nga ju PSSP të implementohet Rezoluta 1325, dhe të:

- Merren masa për pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në proceset e vazhdueshme për të ardhmen e Kosovës,
- Të sigurohet që të gjithë aktorët e involvuar të përfshijnë perspektivën gjinore.

Sinqerisht

Fondacioni Kvinna till Kvinna

Fushatës "Të Njohim të Drejtat" nëpër tërë Kosovën

Përmes fushatës "Të Njohim të Drejtat," RRGK-ja ka për qëllim të informojë qytetarët për të drejtat e tyre dhe mekanizmat ekzistues për çështje gjinore. Shfaqja përmban interpretime teatrale dhe këngë si mjet edukimi për të dërguar mesazhin deri te qytetarët. Ak-

torët në këtë shfaqje përdorin monologë dhe dialogë për të bashkëbiseduar me audiencën.

Faza e parë e fushatës është promovuar më 25 nëntor, 2004 në Prishtinë, duke shënuar Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës Ndaj Gruas. Shfaqja është përsëritur në dhjetor,

2004 në Prizren dhe Mitrovicë. Faza e dytë e fushatës "Të njohim të Drejtat" ka filluar në prill, 2005 me që ç' rast janë vizituar qytete dhe fshatra të shumta nëpër Kosovë. RTV21 ishte sponsor medial, ndërsa fushata është mbështetur financiarisht nga UNIFEM.



Safete Rogova, njera nga aktoret në fushatën "Të njohim të Drejtat" duke bashkëbiseduar me banoret e Hasit, Kosovë

Transferim i Kompetencave të Institucionit të Ombudspersonit

Institucioni i Ombudspersonit, i themeluar nën rregulloren e UNMIK-ut 2000/38, promovon dhe mbrojnë të drejtat dhe lirinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Deri më sot, ky institucion është udhëhequr nga ndër-kombëtarë cilët janë emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Tani, Institucioni i Ombudspersonit, Shtylla e III-të e UNMIK-ut për Zhvillim Institucional dhe Komisioni Parlamentar Legjislativ i Kuvendit të Kosovës janë grupe udhëheqëse për transformimin e Institucio-

nit të Ombudspersonit në institucion lokal.

Në takimet e para të grupit punues, një nga përfaqësuesit e OJQ-ve ishte RRGK. Në këtë takim, është prezantuar "një draft kornizë" dhe është kërkuar nga shoqëria civile të kontribuojnë me propozime, komente dhe sugjerime, në mënyrë që të krijohet një institucion i përshtatshëm për qytetarët e Kosovës. Në fund, pjesëmarrësit janë pajtuar të konsultohen me shoqërinë civile kohë pas kohe gjatë fazave të përgatitjes së projektit.



RRGGK-ja Ndihmon në Përpilimin e Strategjisë për të Drejtat e Njeriut

Më 15 korrik, divizioni për çështje gjinore në Zyrën e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, ka organizuar një takim ndërministror për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, me temën "Draft Strategjia për të Drejtat e Njeriut në Kosovë" me theks të veçantë për të

drejtat e grave. RRGK-ja ka marrë pjesë në mënyrë aktive në këto takime që nga themelimi i tyre. Në fillim të shtatorit, RRGK-ja do të organizojë një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar draft strategjinë për të drejtat e njeriut dhe të jap rekomandime të cilat do t'i

adresojnë tek grupi punues ndërministror. Në këtë grup punues, pjesëmarrësit janë pajtuar që duhet të bëhet presion më i madh tek Institucionet e Kosovës për të adresuar përfaqësimin gjinor dhe për të aprovuar planin kundër trafikimit.

Koalicioni Reforma Paraqet Trendet Elektorale, dhe Kërkon Mbështetje të Vazhdueshme

Më 8 korrik, koalicioni Reforma ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me temën, Trendet Elektorale dhe Propozimet për Ndryshime të Sistemit Elektorale. Kjo tryezë ka pasur për qëllim të informojë aktorët kyç për efektet negative që sistemi i tanishëm elektorale mund të ketë në trendet e votimit, dhe të identifikojë mbështetjen për kampanjën e re REFORMA 2005, që do të fillojë këtë vjeshtë.

Reforma është koalicioni i organizatave jo qeveritare të cilat u bashkuan në fillim të 2004 me qëllim të ndryshimit të sistemit elektorale në Kosovë. Komisioni i këtij koalicioni përfshinë: Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe Këshilli

për Mbrojtjen dhe Lirinë e të Drejtave të Njeriut (KLMDNJ). Në këtë tryezë, KIPRED prezantoi raportin, "Trendet Elektorale në Kosovë: 2000-2004." Pas prezantimit, përfaqësuesit nga Komisioni për Zgjedhje, nga Organizata për

Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Departamenti i Zgjedhjeve, shumë organizata lokale dhe ndërkombëtare kanë diskutuar raportin dhe kanë dhënë rekomandime për reformimin e sistemit elektorale në Kosovë.



Përfaqësuesit e REFORMA-së prezantojnë trendet e votimeve dhe propozojnë ndryshime në sistemin zgjedhor - tryeza në Hotelin Grand në Prishtinë më 08 korrik

Qendra Kosovare për Studime Gjinore promovon edhe dy botime

QKSGJ në Prishtinë, anëtare e Rrjetit, më 20 maj ka promovuar rezultatet e hulumtimit "Si Votojnë Gratë në Kosovë?". Hulumtimi ofron informacione për:

- o Çfarë duan gratë kosovare nga politika
- o Për kë votojnë dhe pse
- o Involvimin e tyre në proceset politike
- o Cilin sistem zgjedhor e preferojnë

o Çfarë mendojnë për rolin e shtetit në ekonomi dhe shoqëri, dhe shumë informacione tjera

Hulumtimi ka përfshirë 1005 gra kosovare nga etni të ndryshme, rajone gjeografike, moshë dhe nivele të arsimimit të ndryshëm.

Më 6 korrik, QKSGJ-ja në bashkëpunim me Fondin Urgjent për Veprim promovuan librin "Përgjigje Kryengritëse: Aktivizmi për të Drejtat e Gruas në Vendet me Gjendje Luftë", në shqip. Libri nga Jane Barry ofron informacione të rëndësishme për punonjësit e ardhshëm dhe të UNMIK, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dhe për të gjithë ndërkombëtarët të cilët punojnë në Kosovë dhe në vende tjera në situata post-konflikti. Ky libër ofron shembuj konkret për mënyrën se si ndërkombëtarët mund të përmirësojnë qasjen e tyre në situata në misionet, në vendet të cilat gjinden në situata të pas luftës. Ajo që është shumë më me rëndësi, në libër theksohet roli i rëndësishëm i grave aktiviste dhe kontributi i tyre në situatat e pas konfliktit.

Në fillim të këtij viti QKSGJ ka promovuar edhe publikimin "Përmbledhje në Studime Gjinore" (në shqip) dhe Direktoriumin e OJQ-ve të Grave në Kosovë. Kopjet e katër publikimeve mund të i gjeni në zyrat e Qendrës ose në zyrat e RRGK-së.

Rrjeti i Grupeve t^o Grave t^o Kosov^os

www.womensnetwork.org
rrggk_kwn@yahoo.com
Agim Ramadani Nr. 50/8
Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igballe Rogova
Drejtoare Ekzekutive
igorogova@yahoo.com

Arbnora Kastrati
Menaxhere e Programit
arbnora_k@yahoo.com

Besa Shehu
Menaxhere e Financave
besa_shehu@yahoo.com

Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca
Delina Fico
Luljeta Vuniqi
Marta Prekpalaj
Vjosa Dobruna
Belgjyzare Muharremi
Behar Selimi

*"Zëri i Gruas Kosovare" është
shkruar nga Arbnora Kastrati dhe
dizajnuar nga Nicole Farnsworth.*

www.womensnetwork.org

Informata nga Anëtarët e RRGK

Mundësi për licencimin e këshilltarëve psikosocial

Nga fundi i shtatorit deri në fillim të dhjetorit, organizata "One to One Kosova" në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Universitetin e Prishtinës - Departamenti i Psikologjisë, Asociacioni për Ndhimë Psikologjike në Zagreb dhe Universiteti i Zagrebit do të organizojë një trajnim dhe do të licencojë këshilltarët psikosocial. Ky është një hap i rëndësishëm në Kosovë, me që krijon mundësi për këtë profesion të jetë zyrtarisht i pranuar. One to One Children's Fund në Londër do të financojë këtë trajnim.

Në bazë të intervistave të mbajtura në gusht, dymbëdhjetë kandidatë janë zgjedhur për pjesëmarrje në trajnim. Për më shumë informacione, ju lutem kontaktoni: qkgff_kosova@hotmail.com

"Dera e Hapur" kremton "Ditët e Trashëgimisë Kulturore Evropiane"

Dera e Hapur, anëtare e RRGK-së, me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prej 15 deri më 20 shtator do të organizojë festivalin e artizanateve në Prishtinë, në Qendrën për Rini dhe Sport. Artistët dhe qytetarët të cilët dëshirojnë të promovojnë punën e tyre janë të ftuar të marrin pjesë. Punimet e drurit, zbulimet e qëndisura, pikturat, punimet e lëkurave, qeramikave, argjendit dhe instrumentet muzikore janë disa nga gjërat të cilat mund të ekspozohen. Të gjithë janë të ftuar të vizitojnë të dëgjojnë muzikë popullore.

Themelimi i Sistemit për Ndhimë Ligjore në Kosovë

Si pjesë e projektit për themelimin e Sistemit Gjithëpërfshirës për Ndhimë Ligjore në Kosovë, është themeluar grupi punues i quajtur "Ekspertët Ligjor dhe Paneli Institucional për Sistemin e Mbështetjes Ligjore."

RRGK është ftuar të marr pjesë në grupin punues si një nga aktorët kyç në Sistemin për Ndhimë Ligjore. Më herët kanë ekzistuar dy sisteme të ndryshme për ndihmë juridike. E para është udhëhequr nga Departamenti i Drejtësisë - UNMIK, i cili adresonte çështjet kriminale. Ndërsa sistemi i dytë, i financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (EAR), ishte për çështje administrative dhe civile. Shoqata Norma, anëtare e RRGK-së, ishte një nga partnerët implementues për këtë departa-

ment.

Nën rregulloren e re për ndihmë ligjore, dy sistemet ekzistuese do të kombinohen në një. Grupi punues do të përgatis legjislacionin e dyte dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që kjo rregullore të aprovohet dhe të zbatohet. Grupi punues do të takohet çdo dy javë në 6 muajt e ardhshëm.

Konferenca për Shtyp për Planin e Veprimit kundër Trafikimit

Më 15 gusht, Zyra për Qeverisje të Mirë pran Zyrës së Kryeministrit ka organizuar një konferencë për shtyp në mënyrë që të informojë publikun për Planin për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore. Qeveria e Kosovës ka aprovuar këtë plan në fillim të gushtit të viti 2005. Përveç mediave, në këtë konferencë ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga institucione lokale dhe ndërkombëtare.



RRGK duke u konsultuar me eksperte lokale nga mbarë Kosova për planin dhe programin e Rrjetit.

Vazhdimi, i takimit të RRGK me Ministrin Selmanaj

Nazife Jonuzi nga OJQ Liria (Gjilan), dhe Arbnora Kastrati menaxhere e programit në RRGK. Ato i prezantuan Z. Selmanaj çështjet në vijim: o Ligji për Shërbimet Sociale nuk është implementuar tërësisht o Strehimoret nuk janë përfshirë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës o Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Departamenti i Drejtësisë, edhe pse është i obliguar të ndihmojë dhe mbështes rastet e dhunës që iu referohen atyre, ata këto raste i referojnë në strehimore.

Kjo do të thotë se Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) dhe UNMIK-u, shfrytëzojnë shërbimet e strehimoreve pa i mbështetur ato financiarisht. Ministri Selmanaj ka kërkuar më shumë të dhëna dhe informacione lidhur me numrin e grave të cilat janë viktime të dhunës në baza gjinore si dhe informacione tjera nga anëtarët e RRGK-së. Ai ka thënë se institucionet janë të gatshme të mbështesin dhe ndihmojnë strehimoret, mirëpo kjo kërkon përkushtim nga të dyja anët. Ai gjithashtu propozoi të organizohet një takim me

Grupin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mënyrë që ky problem të adresohet në organet më të larta ligjvënese.

Ministri Selmanaj falënderoi përfaqësueset e RRGK-së për paraqitjen e shqetësimeve përmes kanaleve institucionale. Ai gjithashtu potencoi se kjo ishte hera e parë që probleme të tilla janë diskutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe se ai do të punojë me qeverinë për të adresuar këto probleme. Ministri Selmanaj tha se vlerëson lartë punën e strehimoreve.